



# Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

*Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave*

Për: z. Bernard Nikaj, U.D i Ministrit të Tregtisë dhe Industrisë  
z. Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës  
Drejtorati për Arsim, Komuna e Prishtinës

Lidhur me: Përmasat shqetësuese të raportuara për përmbajtjen e sulfurit në naftën e nxemjes për shkollat fillore dhe të mesme të Prishtinës

Nga: Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës dhe një grup i prindërve të nxënësve të shkollave të Prishtinës

Po ju drejtohem më këtë letër pas lajmeve shqetësuese që kemi përcjell këto ditë në media, lajmin e botuar në gazetën e përditshme "Zëri" lidhur me dyshimet për ekzistimin e shumëfish të sulfurit në naftën e cila përdoret për nxemje në shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Prishtinës si dhe në institucione tjera.

Për më tutje, shqetësimi ynë vazhdon të thellohet me botimin e sotëm në gazetën 'Zëri' të artikullit 'HIB Petrol shkollave naftë kancerogjene' të datës 4 shkurt 2014.

Artikulli citon të gjeturat nga raporti i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që pas mostrave të marra nga MTI në shkollën fillore 'Gjergj Fishta' në Prishtinë, del se përqindja e sulfurit të gjetur është 600 herë me i lartë sesa niveli i lejuar në Kosovë sipas UA të nxjerrë nga MTI Nr. 07/2012 për Cilësinë e Karburanteve të Lëngëta të Naftës.

Meqë nuk kemi pas asnjë lloj demanti deri më tani nga MTI lidhur me raportin e publikuar në 'Zëri' kjo na përforcon edhe më shumë dyshimin tonë.

Me anë të kësaj letre do të kërkonim një reagim të shpejtë nga institucionet të cilat ju përfaqësoni dhe një përgjegje sa më transparente në një takim se çfarë planifikoni të ndërmirni me këto raportime? Poashtu cilat janë hapat e ardhshme si dhe masat e mundshme të planifikuara nga ana e pozitës së juaj?

Poashtu kësaj letre ju kanë bashkangjitur edhe një grup i prindërve të nxënësve të shkollave të Prishtinës, të shqetësuar, duke qenë të vetëdijshëm se në rastin e Komunës së Prishtinës kjo është një situatë të cilën e kanë trashëguar nga qeverisja e kaluar, por me shpresën se do të hasim në mirëkuptimin e juaj dhe të kemi një përgjegje sa më të shpejtë nga ju.

Sinqerisht,

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK)

# PRESS

[www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org) • Hajdar Dushi St. C-2 II/8, 10000  
Prishtina, Kosovo • +381 (0) 38 245 850 •  
[info@womensnetwork.org](mailto:info@womensnetwork.org)